



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Bujqësisë
Periudha raportuese	Nëntor, 2019
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Shkumbin Gashi

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Duke u bazuar në planprogramin e punës në kuadër të Drejtorisë, brenda periudhës raportuese janë zhvilluar takime me grupet e interesit, fermerë, shoqata të ndryshme, institucione të ndryshme etj.

Realizimi i aktiviteteve të ndryshme në sektorin e bujqësisë që kanë qenë të planifikuara në programin e punës.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj:

- Do të vazhdojmë me pranimin i dokumenteve për aplikuesit në thirrjen e hapur për aplikim në sektorin e bletarisë, gjatë muajit nëntor, deri më 14.11.2019;
- Thirrja e hapur për aplikim për material fidanor është e hapur deri më 14.11.2019;
- Thirrja e hapur për aplikim në përkrahje të fermereve me sistem të ujitjes dhe hapjen e pusit për ujitjen e pemishteve, do të jetë e hapur deri më 14.11.2019;
- Thirrja për aplikim për përkrahjen e fermerëve në ndërtimin e serrave, me sipërfaqe prej 500m² dhe ndërtimi i serrave për kultivimin e materialit fidanor të perimeve;
- Thirrja e hapur për përkrahjen e fermerëve në lëmin e shpendarisë (ngritja e fermave ekstensive për prodhimin e vezëve dhe misht në sistem të lirë të mbajtjes së pulave);
- Gjatë muajit nëntor, do të mbahet takimi përmbyllës i projektit RESI, në bashkëfinancim ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA);

- Planifikohet vizita në terren tek aplikuesit për pajisje: mikser 500kg/h, laktofrizë 500/l, Spërkatëse për trajtimin e pemishteve me preparate kimike, me kapacitet 60/l).

3. *AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë:*

- Ka përfunduar procesi i aplikimit në thirrjen e hapur gjatë muajit nëntor në sektorin e bletarisë, ka filluar më 31.10.2019 deri më 14.11.2019. Numri i aplikueseve në këtë thirrje është 144;
- Është mbyllur thirrja për aplikim për material fidanor, e hapur deri më 14.11.2019. Gjatë kësaj thirrje kanë aplikuar gjithsejt 77 aplikues;
- Ka përfunduar thirrja për aplikim në përkrahje të fermereve me sistem të ujitjes dhe hapjen e pusit. Deri më 14.11.2019 kanë aplikuar 132 aplikues;
- Thirrja për aplikim për përkrahjen e fermerëve në ndërtimin e serrave në sipërfaqe prej 500 m² dhe ndërtimi i serrave për kultivimin e materialit fidanor të perimeve, ka përfunduar më 14.11.2019 dhe kanë aplikuar 41 aplikues;
- Thirrja e hapur për përkrahjen e fermereve në lëmin e shpeztarisë (Ngritja e fermave të pulave për prodhimin e mishit dhe vezëve në natyrë të lirë, ka filluar më 31.10.2019 dhe vazhdon të jetë e hapur deri më 14.11.2019;
- Janë realizuar takime me përfaqësuesit e Agjencisë Austriake për Zhvillim, për të bërë vlerësimin e projektit RESI, të implementuar në tri vitet e fundit, 2017 – 2019, në Komunën e Prishtinës;
- Janë realizuar 7 vizita te përfituesit e subvencioneve dhe granteve, projekte të financuar nga Komuna e Prishtinës dhe donatorët.

4. *AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:*

- Vazhdojmë me pranimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për aplikuesit, në thirrjen hapur për aplikim në sektorin e bletarisë gjatë muajit nëntor, deri më 14.11.2019;
- Thirrja e hapur për aplikim për material fidanor është e hapur deri më 14.11.2019;
- Thirrja e hapur për aplikim në përkrahje të fermerëve me sistem të ujitjes dhe hapjen e pusit për ujitjen e pemishteve, do të jetë e hapur deri më 14.11.2019;
- Thirrja për aplikim për përkrahje e fermerëve në ndërtimin e serrave, me sipërfaqe prej 500 m², dhe ndërtimi i serrave për kultivimin e materialit fidanor të perimeve;
- Thirrja e hapur për përkrahjen e fermerëve në lëmin e shpendarisë (ngritja e fermave ekstensive për prodhimin e vezëve dhe misht në sistem të lirë të mbajtjes së pulave);
- Gjatë muajit nëntor do të mbahet takimi përmbyllës i projektit RESI, në bashkëfinancim ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA).

Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

- Nuk është planifikuar për këtë periudhë.

4.1.3 Takimet me palë

- Kemi pasur 16 takime me palë.

5. Takimet me institucione të tjera

- Nuk kemi pasur.

6. Diskutime publike/Takimet me qytetarë

- Nuk kemi pasur.

6.1.1 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

- Nuk kemi pasur

Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

7. Takime të tjera

- Nuk kemi pasur.

8. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës, apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

9. REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të Drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.

10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:

- Vizita monitoruese te aplikuesit në sektorin e bletarisë në thirrjen e hapur gjatë muajit nëntor 2019;
- Vizita vlerësuese në terren për aplikuesit me material fidanor, për fermerët e komunës së Prishtinës;
- Vazhdojnë vizitat për vlerësimin e aplikueseve gjatë muajit dhjetor për pajisje bujqësore, te fermerët e komunës së Prishtinës;
- Vizita monitoruese te fermeret përfitues të granteve, projekte të mbështetura nga Komuna e Prishtinës dhe Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA);
- Planifikohet takim me fermerët e komunës së Prishtinës për ndër të festave të fundvitit 2019.

11. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.